

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CUBOX” SH.P.K.

Sot, më datë 14/02/2024

SHOQERIA “PANDA” S.R.L me seli ne Rome(RM) ne Rrugen Dalmazia,31 CAP 00198 , me Kapital Social Euro 10.000,00 me Kod Fiskal dhe Nr. Regjistrimi ne Regjistrin e Sipermarrjeve te (RM) me no. 17396751004, perfaqesuar nga Administratori/Perfaqesuesi ligjor i Shoqerise Z. **GIANFRANCO FAIOLA**, lindur ne Rome (RM)-Itali me date 25 Qershor 1971, dhe banues ne Rome (RM) in Rrugen Giuseppe Rosaccio n. 13, qytetar italian, madhore dhe me zotesi te plete per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti italiane me Nr. CA03883HK dhe Nr.493650.

Ka perpiluar kete Akt Themelimi te Shoqerise tregtare “CUBOX” Shpk me termat e meposhtme:

NENI 1


Shoqëria Tregtare “CUBOX” SH.P.K., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “CUBOX” SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.






Objekti i veprimitarise

Veprimtaria e shoqërisë është:

Prodhim softweri, konsulencë ne fushen informatike dhe aktivitetet e lidhura me to,

Prodhimi dhe shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve te lidhura me fushen e informatikes (ICT-Teknologji, Informacion, Komunikim)

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqeria ka seline ligjore:

Adresa: Durres, Lagija 4, Rruga Myfti Kodra, Pallati SIAC, Kati I-re, Shqiperi

Shoqeria mund te hape Filiale, Dege apo Perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë eshte **100.000(njeqindmije) Leke** dhe përbehet nga 1 (nje) kuote.

1) SHOQUERIA "PANDA" S.R.L, është zotëruese e 1 kuote me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 100.000(njeqind mije) leke.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

J.



Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë.

Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjecar, me te drejtë riemerimi. **Administratori i Shoqërisë do të jetë**

Joza MASTORI, shtetase shqiptare, lindur ne Shijak-Durres, me 24/04/1987, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Kartes identitetit me nr. I75424019P per një periudhe 5-vjecare.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijoje çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqerinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqerise. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

ORTAKU THEMELUES

SHOQERIA "PANDA S.R.L."


Perfaqësuar nga

Administratori

Z. **GIANFRANCO FAIOLA**

GIANFRANCO FAIOLA

Perkthyer





STATUTI
I
SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“CUBOX” SH.P.K.

Sot më datë 14.02.2024 në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Ortaku i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, formulon Statutin e saj, si më poshtë vijon:

Ortaku i Shoqërisë eshte:

SHOQUERIA “PANDA” S.R.L me seli ne Rome(RM) ne Rrugën Dalmazia,31 CAP 00198 , me Kapital Social Euro 10.000,00 me Kod Fiskal dhe Nr. Regjistrimi ne Regjistrin e Sipermarrjeve te (RM) me no. 17396751004, perfaqesuar nga Administratori/Perfaqesuesi ligjor i Shoqerise

Z. GIANFRANCO FAIOLA, lindur ne Rome (RM)-Itali me date 25 Qershor 1971, dhe banues ne Rome (RM) in Rrugën Giuseppe Rosaccio n. 13, qytetar italian, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, Karte identiteti italiane me Nr. CA03883HK dhe Nr.493650.

ka përpiluar këtë Statut të Shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar me emertimin **“CUBOX” SH.P.K.**, me termat si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare **“CUBOX” Sh.p.k.** rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrdhëniet e Shoqërive Tregtare, (në vijim **Shoqëria**).



NENI 1

Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj "CUBOX" SH.P.K.

Shoqeria e ka seline LIGJORE :

Adresa: Durres, Lagjja 4, Rruga Myfti Kodra, Pallati SIAC, Kati I-re, Shqiperi

Shoqeria mund te hape Filiale, Dege apo Perfaqesi ne te gjithe territorin shqiptar dhe jashte tij.

NENI 2

Objekti Veprimitarise

Objekti i veprimitarisë se Shoqerise eshte si vijon

Prodhim softweri, konsulencë ne fushen informatike dhe aktivitetet e lidhura me to,

Prodhimi dhe shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve te lidhura me fushen e informatikes (ICT-Teknologji, Informacion, Komunikim)

NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë.

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 4.

Regjimi juridik i Shoqërsë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

Ajo do të organizohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimitaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të janë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj. Statuti mund të ndryshojë duke ndjekur normat e mësipërme. Shoqëria gjëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.





II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.

NENI 5.

Ortaku nuk mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë përveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhin në kapitalin fillestar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.

NENI 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.

Ortaku jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informon ortakun për securinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe securinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do t'u përhapej personave të paautorizuar do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë.

Ortaku ka të drejtë të heq dorë nga shoqëria dhe të shese pjesën e tij të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ate nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortaku vepron, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpinqet për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 7.

Abuzimi i ortakut ndaj shoqërisë

Ortaku i shoqërisë tregtare, që kryen një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjet personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tij nëse:



- 
- a) abuzon me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
 - b) trajton pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishte pasuria e tij;
 - c) në çastin kur merr apo duhet të kishte marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk merr masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.

NENI 8.

Aktiviteti i Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë e të tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

NENI 9.

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë eshte **100.000(njeqindmije)** Leke dhe përbehet nga 1 (nje) kuote.

1) SHOQUERIA “PANDA” S.R.L, është zotëruese e 1 kuote me 100 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 100.000(njeqindmije) leke.

NENI 10.

Pronësia mbi kuotat

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

NENI 11.

Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme për fitimin apo kalimin e kuotave.

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.



Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

NENI 12.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asamblea e Përgjithshme me 3/4 e votave.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakut.

NENI 13.

Fondet rezerve

Shoqëria disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 14.

Përdorimi i të ardhurave neto.

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kreditin për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortaket sipas qëllimeve të tyre.

NENI 15.

Bilanci, plani finanziar.

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakut ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani finanziar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 16.

Shpërndarja e fitimeve

Ortaket kane të drejtë të ndaje pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi i shpërndahet ortakut në raport me kuotat e zotëruara.

J

J





NENI 17.

Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitimin ortakeve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kerkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortaku, që ka marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u eshte shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, ky ortak ka patur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për këtë gjendje.

IV. ORGANET E SHOQËRISË.

NENI 18.

Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asamblea e Përgjithshme. Asamblea e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë 3/4 e votave në rastet e mëposhtme:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. shpërndarjen e fitimeve;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

- 1 Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 2 çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 3 përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- 4 emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- 5 emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- 6 përcaktimin e shpérblimeve për administratoret, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
- 7 mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- 8 miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- 9 pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- 10 përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

NENI 19.

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo ortaku të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

J

G
?



- Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
- Në raste e parashikuara në pikën një dhe tre Asamblea e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

NENI 20.

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 21.

Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 51% për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.



Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

NENI 22.

Proçesverbal i mbledhjes se asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të registrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 23.

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i Emerimit i Administratoreve nuk mund te jete me shume se 5-vjet, me te drejte riemerimi. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të caktojë rregulla të posacme për emerimin e administratorëve.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Administrator i Shoqërisë do të jetë:

Joza MASTORI, shtetase shqiptare, lindur ne Shijak-Durres, me 24/04/1987, madhore dhe me zotesi te plete per te vepruar, mbajtese Kartes identitetit me nr. I75424019P per nje periudhe 5-vjecare.

(Signature)

Shoqëriá do të përfaqësohet përpara ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratorët e Shoqërisë, të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.


NENI 24.

Të drejtat dhe kopetencat e administratorit

Administratori ka të drejtë të:

1. Te kryej veprime te administritmit të shoqerise;
2. Te kryej te gjitha aktet administrative te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te caktuara nga Asambleja e per gjithshme;
3. Te përfaqësojë shoqerinë tregtare;
4. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
5. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
6. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
7. kryejë regjistimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
8. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
9. kryeje detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.





VI. PRISHJA E SHOQËRISË LIKUJDIMI.

NENI 25.

Shoqëria prishet në rast kur:

1. kur mbaron kohëzgjatja e themelimit të saj;
2. me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
3. në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqerisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
4. në raste të tjera, të parashikuara në statut;
5. në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
6. për cdo shkak tjeter të vendosur nga asambleja e ortakeve, etj.;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratorët.

NENI 26.

Likuidimi i shoqërisë

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsyet e mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate.

11

Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit.

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënim i "në likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

NENI 27.

Të drejtat e detyrimet e likuiduesve

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

NENI 28.

Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

2

12



NENI 29.

Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT.

NENI 30.

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 31.

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimi shtëpiake në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKU THEMELUES

SHOQERIA "PANDA S.R.L."

Perfaqësuar nga

Administratori

Z. GIANFRANCO FAIOLA



Perkthyes!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER FLORIAN F. HOXHA



V2024011710010552358

DATE 14/02/2024
NR REP 222



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 14/02/2024 (Dymije e njezet e kater), para meje Noter FLORIAN F. HOXHA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, NR.641, NR.27, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT: GIANFRANCO FAIOLA, atësia Vincenzo, amësia Maria Antonietta, shtetas italian, lindur në Rome dhe banues në Rome, me adresë Itali, Via Giuseppe Rosaccio, No.13 Roma, lindur më 25/06/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Karte identiteti italiane me nr. 493650 dhe nr. personal CA03883HK.

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkruajti përpara meje Noterit dhe ne prezence te perkthyeses se gjuhes italiane Arda A.Grucka, "Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shogerise "CUBOX" shpk ", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gëрма "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
FLORIAN F. HOXHA

ATTO DI COSTITUZIONE
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA
"CUBOX" SRL

Oggi, il 14/02/2024

La Società "PANDA" S.R.L iscritta alla Registro delle Imprese di Roma(RM) con Codice Fiscale e P.iva 17396751004, con sede in Roma(RM) Via Dalmazia,31 CAP 00198, con Capitale Sociale Euro 10.000,00, Rappresentata dal Rappresentante legale Sig . **GIANFRANCO FAIOLA**, Cittadino italiano, nato il 25 giugno 1971 a Roma(RM) – Italia e residente in Via Giuseppe Rosaccio n. 13 Roma(RM) – Italia, maggiorenne e con piena capacità di agire, titolare del Pasaporto Italiana / carta di identità italiana Nr. CA03883HK e numero 493650

ha redatto questo Atto Costitutivo della Società commerciale " CUBOX " SRL, con i seguenti termini:

ARTICOLO 1

Società commerciale " CUBOX " SRL, è costituita in forma di Società a Responsabilità Limitata, ai sensi della Legge 9901, del 14/04/2008 "Per i Commercianti e le Società Commerciali", e le altre disposizioni della legislazione albanese in vigore che regolano i rapporti delle società commerciali ", (di seguito la Società).

La società è una persona giuridica albanese.

ARTICOLO 2

Nome dell'azienda e sigillo

La società entrerà in circolazione legale-civile con la denominazione " CUBOX " Srl. avrà anche il suo timbro.

ARTICOLO 3

L'oggetto dell'attività

La Società ha come oggetto lo svolgimento delle seguenti attività:

Produzione di software, consulenza informatica e attività connesse,


1

Produzione e scambio di beni e servizi relativi al attività dell’informatica (ICT-Information Communication Technology)

ARTICOLO 4

Sede dell’azienda

L’azienda ha sede legale:

Durazzo, Lagja 4, Rruga Myfti Kodra, Pallati SIAC, Kati I-re, Albania.

La società può aprire Filiali, Rami oppure Rappresentanze in tutto il territorio albanese e all'estero.

ARTICOLO 5

Capitale aziendale:

Il capitale sociale sarà costituito dai conferimenti dei soci fondatori della Società. Il

Capitale sociale

della società del valore di **100.000 (centomilla) Lek** albanese ed è composto da 1 (una) quota.

- 1) **La Società “PANDA” S.R.L** è titolare di 1 quota con il 100% di partecipazione al capitale della società del valore di 100.000 (centomilla) lek albanese.

ARTICOLO 6.

Durata della Società

Il termine per lo sviluppo dell’attività della società è indefinito e inizia con la sua iscrizione al Registro Nazionale delle Imprese.

ARTICOLO 7

Organi di governo

Facendo riferimento alla legge n. 9901, del 14/04/2008 "Per i Commercianti e le Società Commerciale", gli organi di governo della società sono i seguenti:

1. Assemblea Generale dei Partner – il più alto organo decisionale;
2. Amministratori – l’organo esecutivo e amministrativo della società.

L’organizzazione e il funzionamento di questi organi è definito nello statuto della società. La società è amministrata da un Amministratore, che sarà eletto per un mandato di 5 anni, con diritto di riconferma. L’amministratore della Società sarà la



Sig.ra Joza MASTORI, cittadina albanese, nata a Shijak-Durres, il 24/04/1987, maggiorenne e con piena capacità di agire, titolare della Carta identità nr. 175424019P, per un periodo di 5(cinque) anni.

La Società è rappresentata dinanzi a qualsiasi ente amministrativo, giudiziario, pubblico o privato e nei rapporti con i terzi dall' Amministratore, il quale eserciterà tali diritti in conformità allo Statuto sociale e alla normativa vigente.

ARTICOLO 8

Il socio fondatore può decidere di sua spontanea volontà di partecipare ad altre società e di creare qualsiasi altro tipo di attività privata, fatte salve le limitazioni previste dalla legge.

ARTICOLO 9

L'organizzazione e il funzionamento della società, l'istituzione delle sue succursali o filiali, avverranno in conformità con le disposizioni della legge e dello statuto in materia.

ARTICOLO 10

